

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi, Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.A. nga fsh. ... Komuna e Gjilanit dhe A.L. nga fshati ... Komuna e Kamenicës, për shkak të veprës penale Grabitja nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e mbrojtësve të akuzuarve B.A. dhe A.L., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.71/2018 datë 13.04.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 24.05.2018 mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve B.A. dhe A.L., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, PKR.nr.71/2018 datë 13.04.2018, **vërtetohet.**

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.71/2018 datë 13.04.2018, të akuzuarit B.A. dhe A.L. i ka shpallur fajtorë për shkak të veprës penale Grabitja nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, ashtu që të njëjtit për veprën penale të Grabitjes nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës i ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 1500 euro dhe me dënim burgimi prej nga 4 (katër) vite ndërsa për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së, i ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej nga 500 euro ashtu që duke aplikuar dispozitat e nenit 80 të KPRK iu ka shqiptuar dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 4 viteve dhe 2000 euro secilit veç e veç në të cilin dënim iu është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 23.03.2018. Iu është shqiptuar edhe dënimi plotësues marrja e armës-pistoletës “Zoraki-m 906-B” me numër serik 000476, kalibër 7.65 mm si dhe 7 fishek. I ka obliguar të paguajnë paushallin gjyqësor nga 40 euro si dhe nga 50 euro për viktimat e krimit si dhe shpenzimet procedurale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë kanë paraqitur:

- Mbrojtësi i të akuzuarit B.A. av. M.M., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoj si të bazuar ankesën, aktgjykimi kundërshtuar të ndryshohet sa i përket vendimit mbi dënim ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë me burg dhe me gjobë.

-Mbrojtësi i të akuzuarit A.L. av. L.A., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoj si të bazuar ankesën, aktgjykimin e kundërshtuar ta anulojë dhe lëndën ta kthej në rigjykim apo të ndryshohet sa i përket vendimit mbi dënim ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë..

- Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.200/2018 të dt. 10.05.2018 ka propozuar që ankesat e mbrojtësve të akuzuarve B.A. dhe A.L. të refuzohen si të pa bazuara.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në të cilën nuk mori pjesë Prokurori i Apelit edhe pse i ftuar me rregull ndërsa prezent ishin i akuzuari B.A. dhe A.L. ndërsa nuk ishin prezent mbrojtësit L.A. dhe M.M. edhe pse të ftuar me rregull, mirëpo meqë të akuzuarit gjenden në paraburgim me pëlqimin e tyre ua caktoi sipas detyrës zyrtare dhe ate të akuzuarit B.A. av. Ramë Gashi ndërsa të akuzuarit A.L. av. E.M.. Mbrojtësit mbetën pranë ankesave të ushtruara nga kolegët e tyre ndërsa të akuzuarit mbështetën mbrojtësit e tyre.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesat janë të pa bazuara.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesat janë të pa bazuara. Në ankesën e mbrojtësve të akuzuarve nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që do të ndikonte në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit. Mbrojtësi i të akuzuarit B.A. thekson se dënimi me burg dhe me gjobë është shumë i ashpër dhe i lartë për faktin se i mbrojturi i tij në të gjitha fazat e procedurës ka bashkëpunuar me organet, ka pranuar veprimet inkriminuese, ka shprehë keqardhje dhe pendim, ka kërkuar falje të dëmtuarve dhe familjarve dhe ka premtuar se nuk do të përsëris veprën penale apo të ngjashme ashtu që bazuar në këto dënimi është enorm e po ashtu edhe gjoba pasi i njëjti ka gjendje jo të mirë ekonomike dhe është i moshës së re. Ndërsa mbrojtësja e të akuzuarit A.L. ka theksuar se vendimi mbi dënim është tepër i lartë pasi i mbrojturi i tij është i gjendjes së varfër ekonomike, është i moshës së re dhe me një dënim të tillë nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit. Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe atë pranimin e fajësisë të cilën gjykata e shkallës së parë por edhe kjo gjykatë e ka vlerësuar si rrethanë veçanërisht lehtësuese, pendimin e tyre dhe premtimin se nuk do të përsërisin veprat penale si dhe moshën e re të tyre ndërsa në anën tjetër rrezikshmëria e

veprës penale dhe mënyra e kryerjes duke siguruar edhe armën vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarve si ekzekutor, gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimet nën minimumin e paraparë ligjor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
PAKR.nr.211/18, më 24.05.2018

Procesmbajtës,  
Bajram Rexhahmetaj

Kryetare e kolegjit- gjyqtarja  
1. Mejreme Memaj\_\_\_\_\_

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi\_\_\_\_\_

3. Afrim Shala \_\_\_\_\_